



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

**PROJEKT VENDIM**  
Nr. 3 datë: 18/09/2023

**Mbi "Miratimin e objektit "Rikonstruksionin e Urës pasarelë HD 80 ml**  
**në fshatin Mnelë "me fondet e akorduara ne programin "Emergjencia Civile**

**Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:**

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhezimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave per vitin 2016, shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.86/6 dt.27.03.2023 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"si dhe të shkresës së Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.4234/1 dt.27.03.2023,

Për sa më sipër, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe Finances) si dhe Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të marrë masa parandaluese,lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në Urën pasarelë HD 80 ml me vendodhje në fshatin Mnelë të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë objektin "Rikonstruksion i Urës pasarelë HD 80 ml në fshatin Mnelë" të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës, nga fondi i akorduar per programin e emergjencave më vlerë **2.491.106.<sup>32</sup> leke** (Dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtë (pike tridhjetë e dy) lekë , e cila është celur në degën e thesarit me kod produkti 91707AG sipas shkresës së Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.4234/1 dt.27.03.2023.



2. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të familjeve që banojnë në zonën ku ndodhet ura.
3. **Për zbatimin** e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Publike, Njesia e Prokurimeve Publike, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe Finances).
4. **Darimi i financimit** do të jetë fondi i planifikuar në programin "Emergjencat Civile" "i sipas shkresës Nr.86/6 dt.27.03.2023 "Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" per vitin 2023.

Konfirmoi bazen ligjore

*Fushinë' Shtetit'*

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

*Valjeta NIKAJ*

KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI

Gjovalin ZEFI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KRYETARI

Nr. 2096 Prot

Datë 23/03/2023

**URDHËR**  
Nr. 125 datë 23.03.2023  
Për "Ngritje komisioni"

Mbështetur në ligjin Nr.45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen Civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.1185/1 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të Emergjencave Civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme", VKM nr.414 dt.08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile i ndryshuar, për verifikimin e dëmeve të Urës në Lagjen "Rreth" të fshatit Mnelë e Madhe të Njësise Administrative Vig Mnelë bazuar në kërkesën me nr.praktike 653 dt.17.03.2023 të kryetarit të fshatit Mnelë e Madhe z.**Sandër Nikolli** të Njësise Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës

**URDHËROJ:**

- Ngritjen e komisionit të mëposhtëm për verifikimin e dëmeve në Urën e Lagjes "Rreth" të fshatit Mnelë e madhe të Njësise Administrative Vig Mnelë.

✚ Valjeta Nikaj	Kryetare
✚ Kimete Demaj	Anëtare
✚ Lazër Gjergji	Anëtar
✚ Ardian Firza	Anëtar
✚ Sandër Nikolli	Anëtar
- Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri komisioni i lartpërmendur.
- Afati për përpilimin e proces verbalit të konstatimit dhe të vlerësimit të rastit është data 24/03/2023.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi  
Valjeta NIKAJ

KRYETARI  
Mark BABANI

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks: 00355 2612 0006, E-mail: [info@vaudejës.gov.al](mailto:info@vaudejës.gov.al)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU-DEJËS  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 2100 ..... Prot

Vau Dejës, me 23/03/2023

**PROCES VERBAL KONSTATIMI**

I Mbajtur sot me datë 09.03.2023 në fshatin Nënshat (mes Nenshat dhe Krajën) të Njësise Administrative Hajmel nga komisioni i ngritur me Urdhrin Verbal të kryetarit të Bashkisë pas marrjes së informacionit nga Salla Operative e e Komisarariatit të Policisë Vau-Dejës mbi konstatimin e objektit ujembledhës (rezervuar) që rrezikon përmbytjen e tokave bujqësore në fshatin Nënshat të Njësise Administrative Hajmel.

Gjatë verifikimit në vend u konstatua se:


1. Në kufirin administrative të Bashkisë Lezhë dhe Bashkisë Vau-Dejës (sipas faqes zyrtare të ASIG-ut) në një përrua është ndërtuar një ujëmbledhës privat dhe se diga e këtij ujëmbledhësi është dëmtuar ku avancimi në tepër i këtij dëmtimi rrezikon disa shtëpi banimi dhe objekte të tjera ekonomike si stalla, magazinë etj të Lagjes "Curkë" të fshatit Nënshat të Njësise Administrative Hajmel të Bashkisë tonë.
2. Në rreth 20-30% të pjesës së sipërme të digës kemi shembje të dherave të hedhura gjatë periudhës së vcerës , por pa demtuar trupin e digës që ka patur në momentin e ndërtimit.
3. Nisur nga kjo shembje pronari kishte marrë masa për shterrimin përfundimtar të tij , ku përveç tubacionit të shkarkimit të ujëlëshuesit , nga ana veriore kishte hapur dhe një kanal dhe po vazhdonte punën për shkarkimin e ujërave me anë të një motorpompe të fuqishme. Në momentin e verifikimit niveli i ujëmbledhësit kishtë rënë rreth 3 m. Gjithashtu ish in marrë masat që puna të vazhdonte gjatë gjithë natës në të dy drejtimet dhe me motopompë dhe me tubacionin e shkarkimit të ujëlëshuesit.
4. Nga verifikimet tona , mendojmë që rrëshqitjet e dheut të hedhur në trupin e digës nuk përbëjnë problem për çarjen e saj , megjithatë ne ju lamë detyrë që

puna për tharjen e ujëmbledhësit të vazhdojë pa ndërprerje deri në tharjen e plotë të saj.


Bashkëlidhur këtij proces verbali do të gjeni edhe kopjen e hartave sipas zonave kadastrale përkatëse dhe foto.

### KOMISIONI

Valjeta Nikaj



Zef Pashuku



Elvis Preçi



Ing. Kimete Curri



**MIRATO HET**  
**KRYETARI**  
Mark **BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV/KRYETARI**

Kristian **SHKRELI**



## Relacion

Objekti: "Ura Pasarelë HD(hapësirë drite) =80 ml në fshatin Mnelë Lagjia Rreth

Vendodhja: Mnelë e vogël, Njësia Administrative Vig Mnelë, Bashkia Vau-Dejës

Bazuar në urdhrin e punës të ngritur nga titullari i Bashkisë Vau Dejës me nr.125 datë 23.03.2023, grupi i punës verifikoi gjendjen në të cilën ndodhet ura pasarelë HD=80 ml në fshatin Mnelë e vogël (lagjia Rreth)

Ura pasarelë HD 80 ml ndodhët në fshatin Mnelë e vogël të Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës , në zonën kadastrale 2708 .

Gjatë inspektimit në terren u kryen matjet e urës pasarelë , nga të cilat rezultoi se ura pasarelë është 80 ml e gjatë. Ura Pasarelë është e ndërtuar me bazament betoni, ku paraqet dëmtime strukturore si në bazamentin e betonit ku duhen berë përforcime dhe në shpatulla si dhe zevëndësim të dërrasave të dëmtuara.

Në vlerësimin e dëmëve të objektit, duhen marrë parasysh çmimet e referencës nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe në përzgjedhja e zërave të punës të bëhet në mënyrë të tillë, që ura të rikthehet në gjendje optimale përdorimi(funksionimi).

Punimet ndërtimore që duhet të kryhen në këtë urë janë si më poshtë:

Gërmim për themele me ekskavator me zinxhir  
Bazamente b/a monolite c 16/20  
F.V.hekur  $\varnothing > 10$   
F.V.lendë e sharruar  
F.V bulona  $\varnothing 14$  (107 cope)  
Bojë vaji me sipërfaqe druri

Spektori i Emergjencave Civile pranë Bashkisë disponon shumën **2.491.106.<sup>32</sup>lekë** për kodin **91707AG** –Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njërvëve (sipas shkresës tonë nr.2280/1 dt.30.03.2023) në përgjigje shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.86/6 dt.27.03.2023 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" që do të përdoret bazuar në Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave.

Punoj :Ing.Kimete Demaj

Lazër Gjergji



Pr. 5705 P. 1  
dt 15.08.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MBROJTJES  
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

Nr. 1602/prot  
11

Tiranë, më 12.9.2023

**Lënda:** Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

**BASHKIA VAU - DEJËS**

**Vau-Dejës**

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bazuar ligjit 45/2019, "Për mbrojtjen civile", përkatësisht kreu II, neni 8, shkronja ç, kreu II, neni 23, shkronja d dhe neni 15 të ligjit 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", dhe VKM-së nr. 290, datë 17.05.2023, "Për një ndryshim në Vendimin nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", në kuadër të ushtrimit të detyrave funksionale, konstatojmë se:

Referuar raportimeve periodike të përcjella nga njësitë e qeverisjes vendore, në lidhje me mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar, i cili me qëllim përdorimin sipas specifikimeve të kuadrit nënligjor në fuqi është ndarë në dy kode produktesh 91707AG dhe 91707AB, rezultojnë vonesa në zbatimin e planifikimit për shpenzimin e fondit të kushtëzuar në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Për sa më sipër, fondi i akorduar të përdoret brenda viti buxhetor, sipas përcaktimeve të renditura në kuadrin nënligjor i cili është ndryshuar pikërisht me qëllim zgjidhjen e pretendimeve të përcjella nga ana juaj, dhe raportimi të realizohet brenda afateve ligjore konform VKM-së nr. 414 datë 08.07.2021.

Për mosrespektim të këtij afati ju bëjmë me dije se do informojmë, institucionet përkatëse për Mbrojtjen Civile dhe Kryeministrinë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI PËRGJITHSHËM  
Haki Cako